



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008 dhe të nenit 36, paragrafi 36.1 i Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110 - 391, dt. 25.2.2010, dhe të nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 02/15, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

th ë r r e t

mbledhjen e **tretë** të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, e cila do të mbahet më **15.05.2017**, dhe do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, rr. "UÇK", nr. 2.

Për mbledhje propozon këtë

REND TË DITËS:

1. **Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së parë dhe të dytë të Kuvendit të Komunës;**
2. **Propozimvendimi për caktimin e një anëtari në Komisionin Komunal të Aksionarëve në K.R.M. "Pastrimi";**
3. **Diskutim lidhur me raportin tremujor financiar, janar - mars 2017;**
4. **Bartja e buxhetit të pashpenzuar të të hyrave vetjake nga viti 2016 në vitin 2017;**
5. **Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS);**
6. **Propozimvendimi për këmbimin e pronave të paluajtshme të Komunës me prona të paluajtshme të personave fizikë;**
7. **Propozimvendimi për lënie në dispozicion të Projektplanit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re - Zona Lindje";**
8. **Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm "Kodra e Trimave 1";**
9. **Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për blloqet: B 17, B 18, B 19 dhe B 20 - lagjja "Mati 1" 2017 - 2025;**
10. **Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim N.P.L. "Hortikultura";**

Vërejtje: Luteni që të merrni pjesë në mbledhje. Në rast pamundësie për të marrë pjesë, lajmërohuni në

Shërbimin e Kuvendit, në tel. kontaktues: 038/230-900, lok. 1100.

11. Propozimvendimi për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Ambasadës së Republikës së Shqipërisë;
12. Propozimvendimi për dhënie e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë Fondacionit për mbrojtjen e kafshëve "Vier Pfoten";
13. Pyetje dhe përgjigje;
14. Të ndryshme.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-060/01-0103109/17, më 04.05.2017

KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS
Halim Halimi, jur. i dipl.

Vërejtje: Luteni që të merrni pjesë në mbledhje. Në rast pamundësie për të marrë pjesë, lajmërohuni në Shërbimin e Kuvendit, në tel. kontaktues: 038/230-900, lok. 1100.